

Home Theatre System

Udhëzimet e përdorimit

Fillimi

Funksionet dhe veçoritë

Funksioni BLUETOOTH

Funksioni rrethues

Cilësimet e përparuara

Informacion shtesë

PARALAJMËRIM

Mos e instaloni pajisjen në hapësira të kufizuara si p.sh. në rafta librash apo në mobilie inkaso.

Për të reduktuar rrezikun e zjarrit, mos mbuloni hapësirën e ajrimit të pajisjes me gazeta, mbulesa tavoline, perde, etj. Mos e ekspozoni pajisjen ndaj burimeve me flakë të pambrojtur (për shembull, qirinjtë e ndezur).

Për të reduktuar rrezikun e zjarrit ose goditjeve elektrike, kjo pajisje nuk duhet të ekspozohet ndaj pikimeve ose spërkatjeve me ujë dhe mbi pajisje nuk duhen vendosur objekte të mbushura me lëng, siç janë vazot.

Njësia nuk shkëputet nga rrjeti elektrik për sa kohë që është e lidhur me prizën e rrymës së drejtpërdrejtë, edhe nëse njësia vetë është e fikur.

Duke qenë se spina kryesore përdoret për të shkëputur njësinë nga rrjeti elektrik, lidhjeni njësinë me një prizë lehtësisht të arritshme rryme të drejtpërdrejtë. Nëse vini re një anomali në njësi, shkëputni menjëherë prizën kryesore nga priza e rrymës së drejtpërdrejtë.

Mos i ekspozoni bateritë ose pajisjet me bateri të instaluar ndaj nxehtësisë së tepruar si p.sh. drita e diellit dhe zjarri.

Vetëm për përdorim në ambiente të brendshme.

Për altoparlantin horizontal (SA-CT660)

Pllaka e parametrave dhe data e prodhimit ndodhen në sipërfaqen që ndodhet poshtë.

Kabllot e rekomanduara

Kabllot dhe bashkuesit e mbrojtur dhe të tokëzuar si duhet, duhet të përdoren për lidhjen e kompjuterëve pritës dhe/ose pajisjeve periferike.

Njoftim për klientët: informacioni i mëposhtëm aplikohet vetëm për pajisjet e shitura në vendet ku aplikohen direktivat e BE-së.

Ky produkt është prodhuar nga ose për llogari të Sony Corporation, 1-7-1 Konan Minato-ku Tokyo, 108-0075 Japoni. Pyetjet në lidhje me pajtueshmërinë e produktit sipas legjislacionit të Bashkimit Evropian do t'i adresohen përfaqësuesit të autorizuar, Sony Deutschland GmbH, Hedelfinger Strasse 61, 70327 Stuttgart, Gjermani. Për çdo çështje shërbimi ose garancie, drejtojuni adresave që jepen në dokumentet e posaçme të shërbimit ose të garancisë.



Përmes kësaj, Sony Corp., deklaron se kjo pajisje është në përputhje me kërkesat themelore dhe dispozitat e tjera përkatëse të Direktivës 1999/5/EC. Për detaje, vizitoni URL-në e mëposhtme:
<http://www.compliance.sony.de/>



Hedhja e pajisjeve të vjetra elektrike dhe elektronike (për Bashkimin Evropian dhe vende të tjera evropiane me sisteme të diferencuara grumbullimi)

Ky simbol mbi produkt ose mbi paketimin e tij tregon se ky produkt nuk duhet të trajtohet si mbeturinë shtëpiake. Përkundrazi, do të dorëzohet pranë pikës përkatëse të grumbullimit për riciklimin e pajisjeve elektrike dhe elektronike. Duke u siguruar që ky produkt të hidhet siç duhet, ju ndihmoni në parandalimin e pasojave të mundshme negative për mjedisin dhe shëndetin, që në rast të kundërt do të shkakttoheshin nga trajtimi i papërshtatshëm i mbetjeve të këtij produkti. Riciklimi i materialeve do të ndihmojë në ruajtjen e burimeve natyrore. Për më shumë informacion të detajuar mbi riciklimin e këtij produkti, ju lutemi kontaktoni me bashkinë tuaj, shërbimin e grumbullimit të mbeturinave shtëpiake ose dyqanin ku keni blerë produktin.

Europe Only



Pb

Hedhja e baterive të përdorura (e aplikueshme në Bashkimin Evropian dhe vendet e tjera evropiane me sisteme të diferencuara grumbullimi)

Ky simbol mbi bateri ose mbi paketim tregon se bateria që vjen me këtë produkt nuk duhet të trajtohet si mbeturinë shtëpiake.

Në disa bateri, ky simbol mund të përdoret i kombinuar me një simbol kimik. Simbolet kimike për zhivën (Hg) ose plumbin (Pb) shtohen nëse bateria përmban më shumë se 0,0005% zhivë ose 0,004% plumb.

Duke u siguruar që këto bateri të hidhen siç duhet, ju ndihmoni në parandalimin e pasojave të mundshme negative për mjedisin dhe shëndetin që në rast të kundërt do të shkakttoheshin nga trajtimi i papërshtatshëm i mbetjeve të kësaj baterie. Riciklimi i materialeve do të ndihmojë në ruajtjen e burimeve natyrore.

Në rast produktesh të cilat për arsye sigurie, rendimenti apo integriteti të dhënash kërkojnë lidhje të qëndrueshme me një bateri të inkorporuar, kjo bateri duhet të zëvendësohet vetëm nga personel i kualifikuar shërbimi. Për të siguruar trajtimin e duhur të baterisë, dorëzoheni produktin në fund të periudhës së funksionimit të tij pranë pikës përkatëse të grumbullimit për riciklimin e pajisjeve elektrike dhe elektronike.

Për të gjitha bateritë e tjera, ju lutemi shihni pjesën që flet mbi heqjen e sigurt të baterisë nga produkti. Dorëzoheni baterinë pranë pikës përkatëse të grumbullimit për riciklimin e baterive të përdorura.

Për të dhëna më të hollësishme mbi riciklimin e këtij produkti ose të baterisë, kontaktoni me bashkinë, shërbimin e grumbullimit të mbeturinave shtëpiake ose dyqanin ku keni blerë produktin.

Masat paraprake

Mbi sigurinë

- Nëse brenda në sistem bie diçka e fortë ose lëng, sistemi duhet të hiqet nga priza dhe duhet të kontrollohet nga një personel i kualifikuar përpara se të vihet sërish në punë.
- Mos u ngjitni mbi altoparlantin vertikal ose nën-vuferin, sepse mund të rrëzoheni dhe mund të lëndoheni, ose mund të dëmtohet sistemi.

Mbi burimet e rrymës

- Përpara se të përdorni sistemin, kontrolloni që tensioni i përdorimit të jetë identik me furnizimin vendas me energji. Tensioni i përdorimit tregohet në pllakëzën metalike në pjesën e pasme të altoparlantit vertikal.
- Nëse nuk do ta përdorni sistemin për një kohë të gjatë, sigurohuni që ta shkëputni sistemin nga priza e murit (rrjeti elektrik). Për të shkëputur kordonin e rrymës së drejtpërdrejtë (rrjetit elektrik), kapeni te vetë priza; mos tërhiqni asnjëherë kordonin.
- Një kunj i spinës është më i gjerë se tjetri për qëllim sigurie dhe do të futet në prizën e murit (rrjetin elektrik) vetëm në një mënyrë. Nëse nuk jeni në gjendje ta futni spinën plotësisht në prizë, kontaktoni me shitësin.
- Kordoni i rrymës së drejtpërdrejtë (rrjetit elektrik) duhet të zëvendësohet vetëm nga dyqani i kualifikuar i servisit.

Mbi akumulimin e nxehtësisë

Megjithëse sistemi nxehet gjatë punës, ky nuk është keqfunksionim. Nëse e përdorni këtë sistem vazhdimisht me volum të lartë, temperatura e sistemit e pjesës së poshtme rritet në mënyrë të konsiderueshme. Për të shmangur djegien, mos e prekni sistemin.

Mbi vendosjen

- Vendoseni sistemin në një vend me ajrosje të mjaftueshme për të parandaluar akumulimin e nxehtësisë dhe për të shtuar jetëgjatësinë e sistemit.
- Mos e vendosni sistemin pranë burimeve të nxehtësisë siç janë radiatorët, tubacionet e ajrit, ose në një vend ku bie drita e drejtpërdrejtë e diellit, ku ka pluhur të tepërt, ose tronditje mekanike.
- Mos vendosni asgjë mbi pjesën e pasme të altoparlantit vertikal që mund të bllokojë vrimat e ajrimit dhe të shkaktojë keqfunksionime.
- Nëse sistemi përdoret në kombinim me një televizor, VCR, ose magnetofon, dhe vendoset shumë pranë asaj pajisjeje, mund të krijohen zhurma dhe mund të prishet cilësia e figurës. Në këtë rast, vendoseni sistemin larg nga televizori VCR ose magnetofoni.
- Kini kujdes kur vendosni sistemin mbi dysheme me trajtim të veçantë (të trajtuara me dyllë, vaj, me luster, etj.), duke qenë se mund të rezultojë në njolla ose çngjyrosje.
- Bëni kujdes të shmangni çdo lëndim të mundshëm në cepat e altoparlantit vertikal ose nën-vuferit.

Mbi përdorimin

Përpara se të lidhni pajisje të tjera, sigurohuni që të fikni dhe hiqni nga priza sistemin.

Nëse ka parregullsi ngjyrash në ekranin e një televizori aty pranë

Mund të vërehen parregullsi të ngjyrave në disa lloje televizorësh.

Nëse vërehet parregullsi ngjyrash...

Fikni herë aparatin e televizorit, më pas ndizeni sërish pas 15 deri 30 minutash.

Nëse vazhdojnë të vërehen parregullsi të ngjyrave...

Vendoseni sistemin më larg nga aparati juaj i televizorit.

Mbi pastrimin

Pastroni sistemin me një pëlhurë të butë të thatë. Mos përdorni asnjë lloj pastruesi abraziv, pluhur fërkimi ose solucione si alkooli ose benzina.

Nëse keni pyetje ose probleme në lidhje me sistemin tuaj, ju lutemi kontaktoni shitësin më të afërt të Sony.

Të drejtat e autorit

Ky sistem përmban Dolby* Digital dhe DTS** Digital Surround System.

* Prodhuar me licencë nga Dolby Laboratories. Dolby dhe simboli me dy "D" janë marka tregtare të Dolby Laboratories.

** Prodhuar me licencë nën patentat amerikane me numër: 5 956 674; 5 974,380; 6 226 616; 6 487 535; 7 212,872; 7 333 929; 7 392 195; 7 272,567 dhe patenta të tjera amerikane dhe botërore të marra dhe në pritje. DTS-HD, simboli i saj dhe DTS-HD dhe simboli i saj së bashku janë marka tregtare të regjistruara të DTS, Inc. Produkti përfshin softuerin. Produkti përfshin softuerin. © DTS, Inc. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Marka e fjalës BLUETOOTH® dhe logot janë marka tregtare të regjistruara të zotëruara nga Bluetooth SIG, Inc. dhe çdo përdorim i këtyre markave nga Sony Corporation është me licencë.

Ky sistem përmban teknologji High-Definition Multimedia Interface (HDMI™) (Ndërfaqe multimediale me definicion të lartë).

Termet HDMI dhe HDMI High-Definition Multimedia Interface, si dhe logoja HDMI janë marka tregtare ose marka tregtare të regjistruara të HDMI Licensing LLC në Shtetet e Bashkuara dhe vende të tjera.

Logoja "BRAVIA" është markë tregtare e Sony Corporation.

"x.v.Colour" dhe logoja "x.v.Color" janë marka tregtare të Sony Corporation.

"WALKMAN" dhe logoja "WALKMAN" janë marka të regjistruara tregtare të Sony Corporation.

"PlayStation®" është markë e regjistruar tregtare e Sony Computer Entertainment Inc.

Shenja N është markë tregtare ose markë tregtare e regjistruar tregtare e NFC Forum, Inc. në Shtetet e Bashkuara dhe në vende të tjera.

Android është markë tregtare e Google Inc.

Markat e tjera tregtare dhe emrat tregtarë janë të pronarëve përkatës.

Teknologjia me valë BLUETOOTH

Versionet dhe profilet e mbështetura BLUETOOTH

Profili i referohet një seti standard kapacitetesh për kapacitete të ndryshme produktesh BLUETOOTH. Shikoni "Specifikimet" (faqe 34) mbi versionet dhe profilet BLUETOOTH të mbështetura nga ky sistem.

Shënime

- Në mënyrë që të përdorni funksionin BLUETOOTH, pajisja BLUETOOTH që do të lidhet duhet të mbështesë të njëjtin profil si ky sistem. Edhe nëse pajisja mbështet të njëjtin nivel, funksionet mund të ndryshojnë për shkak të specifikimeve të pajisjes BLUETOOTH.
- Riprodhimi audio në këtë sistem mund të vonohet nga kjo në pajisjen BLUETOOTH për shkak të karakteristikave të teknologjisë me valë BLUETOOTH.

Rrezja e komunikimit efikas

Pajisjet BLUETOOTH duhet të përdoren 10 metra (distancë pa pengesa) nga njëra-tjetra. Rrezja e komunikimit efikas mund të bëhet më e shkurtër në kushtet e mëposhtme.

- Kur një person, objekt metalik, mur apo pengesë tjetër ndodhet mes pajisjeve me lidhje BLUETOOTH
- Vendndodhjet ku është instaluar një LAN me valë
- Rreth furrave me mikrovalë që janë në përdorim
- Vendndodhjet ku mund të ketë valë të tjera elektromagnetike

Efektet e pajisjeve të tjera

Pajisjet BLUETOOTH dhe LAN-i me valë (IEEE 802.11b/g) përdorin të njëjtën brez frekuece (2.4 GHz). Kur përdorni pajisjen tuaj BLUETOOTH pranë një pajisjeje me kapacitet LAN me valë, mund të ndodhin interferenca elektromagnetike.

Kjo mund të rezultojë në shpejtësi më të ulëta të transmetimit të të dhënave, zhurmë apo pamundësi për t'u lidhur. Nëse kjo ndodh, provoni zgjidhjet e mëposhtme:

- Provoni të lidhni këtë sistem dhe celularin me BLUETOOTH ose pajisjen BLUETOOTH kur të jeni të paktën 10 metra larg nga pajisja LAN me valë.

- Fikni pajisjen LAN me valë kur përdorni pajisjen BLUETOOTH brenda 10 metrave.

Efektet në pajisjet e tjera

Transmetimi i valëve radio nga ky sistem mund të interferojnë me funksionimin e disa pajisjeve mjekësore. Duke qenë se kjo interferencë mund të sjellë keqfunksionim, gjithmonë fikeni këtë sistem, celularin me BLUETOOTH dhe pajisjen BLUETOOTH në vendet e mëposhtme:

- Në spitale, trena, aeroplanë, në pikat e karburantit dhe në çdo vend ku mund të jenë të pranishme gaze të djegshme
- Pranë dyerve automatike apo alarmeve të zjarrit

Shënime

- Ky sistem mbështet funksionet e sigurisë që përputhen me specifikimin BLUETOOTH si mjet për të garantuar siguri gjatë komunikimit me teknologjinë BLUETOOTH. Megjithatë, kjo siguri mund të jetë e pamjaftueshme në varësi të përmbajtjes së cilësimeve dhe faktorëve të tjerë, prandaj gjithmonë tregohuni të kujdesshëm kur kryeni komunikimin me teknologjinë BLUETOOTH.
- Sony nuk mund të konsiderohet përgjegjëse në asnjë mënyrë për dëme apo humbje të tjera si rezultat i rrjedhjes së informacionit gjatë komunikimit me BLUETOOTH.
- Komunikimi BLUETOOTH nuk është domosdoshmërisht i garantuar me të gjitha pajisjet BLUETOOTH që kanë të njëjtin profil si ky sistem.

- Pajisjet BLUETOOTH të lidhura me këtë sistem duhet të pajtohen me specifikimin BLUETOOTH të përshkruar nga Bluetooth SIG, Inc. dhe duhet të jenë të certifikuara si të pajtueshme. Megjithatë, edhe kur pajisjet pajtohen me specifikimin BLUETOOTH, mund të ketë raste kur karakteristikat apo specifikimet e pajisjes BLUETOOTH e bëjnë të pamundur që të lidhet, ose mund të rezultojnë në metoda të ndryshme kontrolli, pamjeje apo funksionimi.
- Mund të ndodhë zhurmë ose audioja mund të shkëputet në varësi të pajisjes BLUETOOTH të lidhur me këtë sistem, mjedisin e komunikimit apo kushtet rrethuese.

Pasqyra e lëndës

Masat paraprake	4
Teknologjia me valë BLUETOOTH	5

Fillimi

Shpaketimi	9
Indeksi i pjesëve dhe kontrolleve	10
Lidhja e televizorit, luajtësit, etj.	14
Pozicionimi i sistemit	16
Konfigurimi i sistemit me valë marrësit	18

Funksionet dhe veçoritë

Përdorimi i sistemit duke përdorur telekomandën e dhënë	19
Përdorimi i funksionit Control for HDMI	19
Përdorimi i veçorive të "BRAVIA" Sync	20
Konfigurimi i daljes së zërit nga pajisja e lidhur	21

Funksioni BLUETOOTH

Përdorimi i funksionit BLUETOOTH	22
---	----

Funksioni rrethues

Shijimi i efektit rrethues	26
----------------------------------	----

Cilësimet e përparuara


Cilësimet dhe përshtatjet duke përdorur menyne AMP	27
Lidhja e sistemit (LINK)	30

Informacion shtesë


Zgjidhja e problemeve	31
Specifikimet	34
Indeksi	37

Shpaketimi

- Nën-vuferi (SA-WCT660) (1)



- Altoparlanti horizontal (SA-CT660) (1)



- Kabloja dixhitale optike e televizorit (1)
- Mbajtësja anësore (për montim me pamje përballë) (2)





- Mbajtësja anësore (për montim me anim lart) (2)



- Telekomanda (RM-ANP106) (1)
- Bateritë R6 (madhësia AA) (2)
- Udhëzimet e përdorimit (1)

Futja e baterive në telekomandë

Futni dy bateri R6 (përmasa AA) (të dhëna) në mënyrë që fundet ⊕ dhe ⊖ në bateri të përputhen me diagramin brenda folesë së baterisë së telekomandës. Për të përdorur telekomandën, drejtojeni drejt sensorit të telekomandës  përpara altoparlantit horizontal.




Shënime


- Mos e lini telekomandën në vende të nxehta apo me shumë lagështirë.
- Mos përdorni bateri të re së bashku me një të vjetër.
- Nuk duhet t'ju bjerë asnjë objekt i huaj brenda kasës së telekomandës, sidomos kur zëvendësoni bateritë.
- Mos e ekspozoni sensorin e telekomandës ndaj dritës së drejtpërdrejtë të diellit ose aparaturave që lëshojnë dritë. Përndryshe mund të shkaktoni defekt.
- Nëse nuk do ta përdorni telekomandën për një periudhë të gjatë, hiqini bateritë për të shmangur dëmtimet e mundshme nga rrjedhja dhe gërryerja e baterive.

Indeksi i pjesëve dhe kontrolleve


Për më shumë informacion, shihni faqet e treguara në kllapa.

Altoparlanti horizontal




- 1 Butoni I/⏻ (ndezur/ në gatishmëri)**
- 2 Butoni PAIRING (faqe 23)**
- 3 Butoni INPUT**
Shtypni për të zgjedhur burimin e hyrjes për të riprodhuar.
- 4 Butonat VOL (volumi) +/-**
- 5 N mark**
- 6  (sensori i telekomandës)**
- 7 LED me ndriçim**
Ndizet në të bardhë kur sistemi i altoparlantit është i ndezur.
Ndizet në blu në modalitetin BLUETOOTH.
- 8 Paneli i ekrani të përparmë**
- 9 Fusha e shfaqjes së mesazhit**
Shfaq volumin, burimin e zgjedhur të hyrjes, etj.
- 10 NIGHT (faqe 28)**
Ndizet në modalitetin NIGHT.
- 11 HDMI**
Ndizet kur zgjidhet një sinjal HDMI si burim hyrjeje.
- 12 OPT**
Ndizet kur zgjidhet sinjali nga foleja OPTICAL IN.

Foletë (në pjesën e pasme të altoparantit horizontal)



- 1 Kordoni elektrik (për rrjetin elektrik) (faqe 14)
- 2 Foletë HDMI IN 1/IN 2 (faqe 14)
- 3 Foleja ANALOG IN (faqe 15)
- 4 Foleja OPTICAL IN (faqe 14, 15)
- 5 Foleja HDMI TV OUT (ARC) (faqe 14)
- 6 Foleja HDMI IN 3 (faqe 14)

Nën-vuferi




- 1 Treguesi I/⏻ (ndezur/në gatishmëri)
- 2 Butoni I/⏻ (ndezur/në gatishmëri)
- 3 Butoni LINK (faqe 30)
- 4 Kordoni elektrik (për rrjetin elektrik) (faqe 14)

Telekomanda

Kjo pjesë përshkruan mënyrën e funksionimit të nën-vuferit, altoparantit horizontal dhe pajisjeve të lidhura me telekomandën e dhënë. Nëse nuk arrini ta përdorni pajisjen e lidhur, përdorni telekomandën e pajisjes.

Shënim

- Drejtojeni telekomandën drejt sensorit të telekomandës (📺) të altoparantit horizontal.



- * Butonat ► dhe ◀ + kanë një pikë të prekshme. Përdoreni si udhëzues gjatë përdorimit.

Për të kontrolluar sistemin

- ➡ (hyrja) (faqe 19)
Shtypeni për të zgjedhur pajisjen që dëshironi të përdorni.
 - I/O (ndezur/në gatishmëri)
 - SOUND FIELD +/- (faqe 26)
 - SOUND FIELD (faqe 26)
 - DISPLAY
Sa herë që shtypni këtë buton, ekrani ndizet dhe fiket.
Kur sistemi vihet në punë, ekrani ndizet për pak sekonda.
 - 🔊 (heshtja)
 - ◀ (volumi) +/-
 - AMP MENU (faqe 27)
 - PAIRING (faqe 23)
 - Butoni RETURN
Kthehet në ekranin e mëparshëm të menysë së shfaqur.
 - ← (kthehu)/↑ ↓ (zgjidh)/ → (vazhdo) ose ⊕ (hyr)
Shtypni ←, ↑, ↓ ose → për të zgjedhur artikujt e menysë. Më pas shtypni ⊕ për të futur zgjedhjen.
 - SPEAKER TV ↔ AUDIO
Shtypeni për të nxjerrë zërin e daljes (televizori apo ky sistem) nga altoparantët.
- ## Për të komanduar një televizor
- TV ◀ (volumi) +/-
Rregullon volumnin.
 - TV PROG (programi) +/-
Zgjedh kanalën vijues (+) ose të mëparshëm (-).
 - TV INPUT
Zgjedh hyrjen.
 - TV I/O (ndezur/në gatishmëri)
Ndez ose fik televizorin e caktuar për t'u komanduar nga telekomanda.

Për të komanduar një pajisje BLUETOOTH

9


Për të shkuar në fillim të pjesës së mëparshme ose tjetër muzikore.

10

Për të përshpejtuar para ose prapa muzikën kur shtypet gjatë riprodhimit.

11 **Komandimi i riprodhimit** * (riprodho)/ (pauzë)/ (ndalo)

Nis/vendos në pauzë/ndalon riprodhimin.














Për të rifilluar riprodhimin normal gjatë pauzës, shtypni  (pauzë) sërish.

Shënim

Shpjegimet e mësipërme shërbejnë vetëm si shembull. Në varësi të pajisjes, funksionet e mësipërme mund të mos jenë të mundshme ose mund të funksionojnë ndryshe nga sa përshkruhet.

Vendosja e prodhuesit të televizorëve të kontrollueshëm

1 Ndërkohë që mbani shtypur butonin TV I/⏻, shtypni butonin që i korrespondon prodhuesit.


Prodhuesi	Butoni
SONY	 TV  +
Samsung	 TV PROG +
	 SOUND FIELD +
	 GAME
LG	 SOUND FIELD +
Panasonic	 TV  -
Philips	 TV PROG -
	 MOVIE
	 GAME
Sharp	 SOUND FIELD -
Toshiba	 STD

2 Ndërkohë që mbani shtypur TV I/⏻ shtypni .

3 Lëshoni TV I/⏻.


Lidhja e televizorit, luajtësit, etj.

Përpara se të lidhni kordonin elektrik (rrjetin elektrik) me murin (rrjeti elektrik), lidhni të gjitha pajisjet e tjera dhe një televizor me sistemin. Nuk kërkohen lidhje me kablo mes altoparantit horizontal dhe nën-vuferit sepse ato mund të lidhen me valë.



Lidhja e një televizori

Nëse lidhni sistemin me një televizor të përpunshëm me teknologjinë Audio Return Channel (ARC) përmes një foleje hyrëse HDMI me "ARC" të treguar, nuk ju nevojitet të lidhni një kablo optike dixhitale. Nëse kabloja optike dixhitale ka kapak, hiqeni përpara se të lidhni kabllo.




Shënime

- Ju mund të shikoni shkronjat "ARC" pranë folesë HDMI të televizorit nëse është e përpunshme me teknologjinë Audio Return Channel (ARC). Edhe nëse lidhni një kablo HDMI me follenë, nëse foleja hyrëse HDMI nuk është e përpunshme me teknologjinë Audio Return Channel (ARC), nuk mund ta përdorni teknologjinë Audio Return Channel (ARC).
- Teknologjia Audio Return Channel (ARC) është e disponueshme vetëm kur funksioni Control for HDMI aktivizohet. Nëse funksioni Control for HDMI është çaktivizuar, përdorni një kablo optike dixhitale.
- Lidhjet e folesë HDMI kanë prioritet si cilësimi i parazgjedhur kur lidhni pajisje të ndryshme me sistemin duke përdorur foletë OPTICAL IN dhe HDMI IN.


Këshillë

- Edhe nëse sistemi është i fikur (modaliteti i gatishmërisë aktive), sinjali HDMI do të dërgohet nga pajisja e lidhur me televizorin përmes lidhjes HDMI. Ju mund të shijoni imazhe dhe tinguj nga pajisja në televizor.

Lidhja e pajisjes me një fole HDMI



Lidhja e pajisjeve audio



Shënim


- Kur lidhni një luajtës portabël muzikor, etj. përmes folesë së tij të kufjeve me folenë ANALOG IN të sistemit, rregulloni volumnin në luajtësin portabël muzikor për të eliminuar ndryshimin e volumnit kur kaloni mes luajtësit portabël muzikor dhe burimeve të tjera të hyrjes.

Pozicionimi i sistemit


Ilustrimet më poshtë janë shembuj të instalimit të altoparantit horizontal.

Instalimi i altoparantit horizontal

- Instalimi i altoparantit horizontal në një mbajtëse (faqe 17)



- Instalimi i altoparantit horizontal në mur (faqe 17)




Shënime

- Merrni masat paraprake të mëposhtme kur instaloni altoparantin horizontal dhe nën-vuferin.
 - Mos bllokoni vrima e ajrimit në panelin e pasmë.
 - Mos vendosni altoparantin horizontal dhe nën-vuferin në një kasë metalike.
 - Mos vendosni objekt si akuariumi mes altoparantit horizontal dhe nën-vuferit.
 - Vendosni nën-vuferin pranë altoparantit horizontal në të njëjtën dhomë.
- Kur altoparanti horizontal vendoset përpara një televizori, televizori mund të mos kontrollohet me telekomandën e televizorit. Në këtë rast, vendoseni altoparantin horizontal larg nga televizori. Nëse telekomanda e televizorit vazhdon të mos e komandojë televizorin, vendosni "IR REP" të menysë AMP në "ON" (faqe 29).
- Sigurohuni që telekomanda e televizorit të mos komandojë televizorin, më pas vendoseni "IR REP" në "ON". Nëse vendoset në "ON" kur telekomanda komandon televizorin, mund të mos arrihet përdorimi i duhur për shkak të interferencës mes komandimi të drejtpërdrejtë nga telekomanda dhe komandimit përmes altoparantit horizontal.

Instalimi i altoparlantit horizontal në një mbajtëse


Për të instaluar altoparlantit horizontal me pamje përballë

- 1 Vendosni një mbajtëse anësore (për montim me pamje përballë) në secilën anë.




Për të instaluar altoparlantit horizontal me anim përpara

- 1 Hiqni mbajtësen qendrore.



- 2 Vendosni një mbajtëse anësore (për montim me anim përpara) në secilën anë.





Instalimi i altoparlantit horizontal në mur

Altoparlantit horizontal mund ta montoni në mur.

Shënime


- Përdorni vidha që janë të përshtatshme për materialin e murit dhe forcën e tij. Duke qenë se muret prej gipsi janë veçanërisht të brishtë, vidhat montojini mirë te një tra muri. Instalojini altoparlantit horizontal mbi një zonë vertikale dhe të sheshtë të përforuar të murit.
- Sigurohuni që instalimin ta kryejnë shitësit e Sony ose kontraktorë të licencuar dhe kushtojini kujdes sigurisë gjatë instalimit.
- Sony nuk është përgjegjës për aksidentet ose dëmtimet e shkaktuara nga instalimi i pasaktë, forca e pamjaftueshme e murit, montimi i pasaktë i vidave ose fatkeqësitë natyrore etj.

- 1 Përgatitni vida (nuk jepen) që janë të përshtatshme për vrimat në pjesën e pasme të altoparantit horizontal.**



Vrima në pjesën e pasme të altoparantit horizontal


- 2 Shtrëngojini vidhat në mur.**
Vidhat duhet të dalin përpara 6 deri 7 mm.



- 3 Hiqni mbajtësen qendrore.**

- 4 Vareni altoparantitn horizontal te vidat.**

Radhisni vrimat në pjesën e pasme të altoparantit horizontal me vidhat, më pas vareni altoparantitn horizontal te 2 vidhat.



Konfigurimi i sistemit me valë marrësit

Altoparantit horizontal transmeton zë nga pajisja te nën-vuferi duke komunikuar me valë.

- 1 Lidhni kordonin e rrymës së drejtpërdrejtë (rrjetit elektrik) të altoparantit horizontal me një prizë muri (rrjeti).**
- 2 Lidhni kordonin e rrymës së drejtpërdrejtë (rrjetit elektrik) të nën-vuferit me një prizë muri (rrjeti).**


Treguesi I/⏻ i nën-vuferit ndizet në të kuqe.

Nëse nuk ndizet, shtypni butonin I/⏻ e nën-vuferit dhe prisni treguesin të ndizet në të kuqe.


- 3 Shtypni butonin I/⏻ e altoparantit horizontal.**

Kur kryhet lidhja me valë, treguesi I/⏻ i nën-vuferit bëhet i gjelbër. Nëse nuk bëhet i gjelbër, kryeni veprimet e "Lidhja e sistemit (LINK)" (faqe 30).

Përdorimi i sistemit duke përdorur telekomandën e dhënë

- 1 Ndizni sistemin.
- 2 Shtypni  për të shfaqur burimin e hyrjes në ekranin e panelit të përparmë të altoparlantit horizontal.

Burimi i hyrjes	Pajisjet që mund të lexohen
TV	Televizori i lidhur me folenë HDMI TV OUT (ARC) ose OPTICAL IN
HDMI 1	Pajisjet e lidhura me folenë HDMI IN 1
HDMI 2	Pajisjet e lidhura me folenë HDMI IN 2
HDMI 3	Pajisjet e lidhura me folenë HDMI IN 3
ANALOG	Pajisjet e lidhura me folenë ANALOG IN
BT AU	Pajisja BLUETOOTH e lidhur

- 3 Rregulloni volumnin duke shtypur .

Këshillë

- Zëri mund të mos dalë nga altoparlantët e televizorit. Në këtë rast, ulni në minimum volumnin e altoparlantit të televizorit.

Përdorimi i funksionit Control for HDMI

Duke aktivizuar funksionin Control for HDMI (CTRL, faqe 28) dhe duke lidhur pajisje që janë të përputhshme me funksionin Control for HDMI përmes një kabllaje HDMI, funksionimi është i thjeshtë me veçoritë e mëposhtme.

Fikja e sistemit

Kur fikni televizorin me anë të butonit të energjisë në telekomandën e televizorit, sistemi dhe pajisja e lidhur fiken automatikisht.

Kontrolli i sistemit audio

Nëse ndizni sistemin kur jeni duke parë televizor, tingulli i televizorit do të dalë nga altoparlantët e sistemit automatikisht. Volumi i sistemit përshtatet kur përshtatni volumnin e televizorit.

Nëse zëri i televizorit kishte dalë nga altoparlantët e sistemit herën e fundit që keni fikur televizorin, sistemi ndizet automatikisht kur ndizni sërish televizorin, dhe tingulli i televizorit del nga altoparlantët e sistemit automatikisht.

Audio Return Channel (ARC)

Nëse televizori është i përputhshëm me teknologjinë Audio Return Channel (ARC), lidhja me kablo HDMI e dërgon gjithashtu sinjalin dixhital të audios nga televizori te sistemi. Nuk duhet të kryeni një lidhje të veçantë audio për dëgjimin e zërit të televizorit nga sistemi (ARC, faqe 28).

Luajtja me një prekje

Kur luani përmbajtje në pajisjen e lidhur me sistemin nëpërmjet një kabllloje HDMI, televizori i lidhur ndizet automatikisht dhe sinjali i hyrjes së sistemit kalohet në hyrjen e duhur HDMI.

Shënime

- Veçoritë e mësipërme mund të mos punojnë me pajisje të caktuara.
- Në varësi të cilësimeve të pajisjes së lidhur, funksioni Control for HDMI mund të mos funksionojë mirë. Referojuni udhëzimeve të përdorimit të pajisjeve.

Përdorimi i veçorive të "BRAVIA" Sync

Funksionet origjinale Sony të renditura më poshtë mund të përdoren edhe me produkte që janë të përputhshme me "BRAVIA" Sync.

Kursimi i energjisë

Nëse një televizor i përputhshëm "BRAVIA" Sync lidhet me sistemin, konsumi i energjisë reduktohet në modalitetin e pritjes duke ndaluar transmetimin e sinjalit HDMI kur televizori fiket (P. THRU, faqe 28).

Scene Select

Nëse me sistemin lidhet një televizor i përputhshëm me "Scene Select", fusha zanore ndryshon automatikisht, duke u optimizuar sipas programit që luhet aktualisht në televizorin e lidhur.

Shënime për lidhjet HDMI

- Përdorni një kablllo HDMI të shpejtësisë së lartë. Nëse përdorni kablllo HDMI standard, figura 1080p, Deep Color, 3D/4K mund të mos shfaqet siç duhet.
- Rekomandojmë përdorimin e kablllove të autorizuara HDMI ose të një kabllloje Sony HDMI.
- Nuk rekomandojmë përdorimin e kablllove konvertuese HDMI-DVI.
- Kontrolloni konfigurimin e pajisjes së lidhur nëse cilësia e figurës është e dobët ose nëse zëri nuk del fare nga pajisja e lidhur nëpërmjet kablllos HDMI.

- Sinjalet audio (frekuenca e modulimit, numri i bitëve, etj.) që transmetohen nga një fole HDMI mund të ngjishen nga pajisja e lidhur.
- Zëri mund të ndërpritet nëse ndërrohet frekuenca e modulimit ose numri i kanaleve të sinjaleve audio që dalin nga pajisja luajtëse.
- Kur pajisja e lidhur nuk përputhet me teknologjinë mbrojtëse të së drejtës së autorit (HDCP), figura dhe/ose zëri që del nga foleja HDMI TV OUT (ARC) mund të shtrembërohet ose mund të mos ketë fare dalje të tyre. Në këtë rast, verifikoni specifikimet e pajisjes së lidhur.
- Kur zgjidhet "TV" për burimin e hyrjes së sistemit, dalin sinjalet video përmes një prej foleve HDMI IN që është zgjedhur herën e fundit nga foleja HDMI TV OUT (ARC).
- Ky sistem mbështet transmetime Deep Color, "x.v.Colour", 3D dhe 4K.
- Për të shijuar pamje 3D lidhni një televizor të përputhshëm 3D dhe pajisje video (luajtës Blu-ray Disc, "PlayStation®3", etj.) me sistemin duke përdorur kablo HDMI me shpejtësi të lartë, vendosni syzet 3D dhe më pas riprodhoni disqe të përputhshme me 3D Blu-ray Disc.
- Për të shijuar pamje 4K, televizori dhe luajtësit që lidhen me sistemin duhet të jenë të përputhshëm me pamjet 4K.


Konfigurimi i daljes së zërit nga pajisja e lidhur

Për daljen e audios dixhitale shumëkanalëshe, kontrolloni konfigurimin e daljes së audios dixhitale në pajisjet e lidhura. Për detaje, referojuni udhëzimeve të përdorimit të dhëna me pajisjen e lidhur.

Funksioni BLUETOOTH

Përdorimi i funksionit BLUETOOTH

Çiftimi automatik

Nëse sistemi nuk është çiftuar me asnjë pajisje, duhet të çiftoni sistemin me pajisjen që do të lidhet. Zgjidhni "BT AU" me butonin  në telekomandë për të vendosur modalitetin e çiftimit.

- 1 Vendoseni sistemin dhe pajisjen BLUETOOTH brenda 1 metri.**
- 2 Shtypni  për të zgjedhur "BT AU".**
- 3 Vendoseni pajisjen BLUETOOTH në modalitetin e çiftimit.**

Për hollësi rreth vendosjes së pajisjes BLUETOOTH në modalitetin e çiftimit, referojuni udhëzimeve të përdorimit të dhëna me pajisjen.
- 4 Kur pajisjet e diktuar renditen në pajisjen BLUETOOTH, kontrolloni që "HT-CT660" të jetë e renditur.**

Në disa pajisje BLUETOOTH, lista mund të mos shfaqet.
- 5 Zgjidhni "HT-CT660" në listë.**

Nëse kërkohet futja e kodit, vendosni "0000".

6 Kryeni lidhjen BLUETOOTH në pajisjen BLUETOOTH.

Kur lidhja BLUETOOTH kryhet saktë, dritat LED ndizen në ngjyrë blu dhe informacioni i çiftimit ruhet në sistem.

Rreth dritës LED për BLUETOOTH

Drita LED ndizet ose pulson në ngjyrë blu për të treguar statusin e BLUETOOTH.

Statusi i sistemit	Statusi i dritës LED
Gjatë çiftimit BLUETOOTH	Pulson me shpejtësi në ngjyrë blu.
Sistemi po përipiqet të lidhet me një pajisje BLUETOOTH	Pulson në ngjyrë blu.
Sistemi ka krijuar lidhje me një pajisje BLUETOOTH	Ndizet në ngjyrë blu.
Sistemi është në modalitet gatishmërie BLUETOOTH (kur sistemi është i fikur)	Pulson me ngadalë në ngjyrë blu.

Shënime

- Për hollësi rreth përdorimit të pajisjeve të lidhura, drejtojuuni udhëzimeve të përdorimit të dhëna me pajisjet.
- Pajisjet BLUETOOTH që do të lidhen duhet të mbështesin A2DP (Advanced Audio Distribution Profile).
- Përdorni një pajisje BLUETOOTH si p.sh. telefon me BLUETOOTH në një vend me fushë shikimi në të njëjtën dhomë ku është vendosur altoparlanti horizontal.
- Nëse përdoret pajisje Wi-Fi, komunikimi BLUETOOTH mund të bëhet i paqëndrueshëm. Në këtë rast, përdoreni pajisjen BLUETOOTH sa më pranë të jetë e mundur altoparllantit horizontal.
- Tingulli mund të shkëputet për shkak të një problemi me pajisjen BLUETOOTH.

- Pasi të kryhet veprimi i çiftimit, ai nuk është më i nevojshëm të kryhet sërish. Sidoqoftë, çiftimin duhet ta përsëritni në rastet e mëposhtme.
 - Informacioni i çiftimit fshihet duke riçftuar sistemin.
 - Duhet vendosur çiftimi për 10 ose më shumë pajisje. Ky sistem mund të vendosë çiftimin me deri në 9 pajisje. Nëse duhet vendosur çiftimi për një pajisje pasi është vendosur çiftimi në 9 pajisje, informacioni i çiftimit në një pajisje data e lidhjes së të cilës është më e vjetër mbivendoset me informacionin e ri.
 - Historia e lidhjes me këtë sistem fshihet në pajisjen e lidhur.
 - Sistemi rivendoset në vlerat e parazgjedhura.

Çiftimi manual

Nëse dëshironi të çiftoni sistemin me 2 ose më shumë BLUETOOTH, nevojitet çiftimi manual.

- 1 Vendosni pajisjen BLUETOOTH që do të lidhet me këtë sistem brenda 1 metri nga sistemi.**
- 2 Shtypni PAIRING në telekomandë.**
Në vend të kësaj mund të shtypni PAIRING në altoparllantini horizontal.
- 3 Kryeni hapat 3 deri 6 të “Çiftimi automatik” (faqe 22).**

Shënime

- “Passkey” mund të quhet “Passcode”, “PIN code”, “PIN number” ose “Password”, etj., në varësi të pajisjes.
- Statusi i gatishmërisë së çiftimit të sistemit anulohet pas rreth 5 minutash. Nëse çiftimi nuk është i suksesshëm, kryeni sërish procedurën nga hapi 1.

- Nëse dëshironi të çiftoni me disa pajisje BLUETOOTH, kryeni procedurën nga hapi 1 deri 3 individualisht për secilën pajisje BLUETOOTH.
- Nëse në sistem nuk ruhet informacion çiftimi, sistemi hyn automatikisht në modalitetin e çiftimit kur zgjidhet “BT AU” si hyrje. Në këtë rast, modaliteti i çiftimit nuk lëshohet automatikisht.

Lidhja me një prekje me një celular smartphone (NFC)

Duke prekur sistemin me një celular smartphone, sistemi çiftohet dhe lidhet me celularin smartphone përmes BLUETOOTH dhe aktivizohet automatikisht.

NFC

NFC (Near Field Communication) është një teknologji që mundëson komunikimin me valë me rreze të shkurtër mes disa pajisjeve, si p.sh. celularë dhe etiketa IC. Falë funksionit NFC, komunikimi i të dhënave mund të arrihet thjesht duke prekur simbolin përkatës ose vendin e përcaktuar në pajisjet e përputhshme NFC.

Celularët smartphone të pajtueshëm

Celularët smartphone me funksion NFC të integruar (OS: Android 2.3.3 ose i mëvonshëm, përveç Android 3.x)

- 1 Shkarkoni dhe instaloni aplikacionin “NFC Easy Connect”.**

“NFC Easy Connect” është aplikacion falas Android që mund të shkarkoni nga Google Play. Shkarkoni aplikacionin duke kërkuar “NFC Easy Connect” ose hyni duke përdorur kodin e mëposhtëm dy dimensional.

Mund të aplikohen tarifa për shkarkimin e aplikacionit. Përdorni aplikacion për leximin e kodeve dy dimensionale.




2 Ndizni sistemin.

3 Nisni aplikacionin "NFC Easy Connect" në celularin smartphone.

Sigurohuni që ekrani i aplikacionit të shfaqet.

4 Prekni shenjë N në altoparlantit horizontal me celularin smartphone.

Mbani të prekur altoparlantit horizontal me celularin smartphone derisa celulari të dridhet.



Kryeni lidhjen duke ndjekur udhëzimet në ekran.

Kur drita LED (blu) ndalon së pulsuari dhe qëndron e ndezur, sistemi është lidhur me pajisjen. Për të shkëputur sistemin, prekeni me celularin smartphone sërish.

Këshilla

- Nëse nuk mund ta lidhni sistemin, provoni opsionet e mëposhtme.
 - Nisni aplikacionin në celularin smartphone, dhe lëvizeni celularin me ngadalë mbi shenjë N të altoparlantit horizontal.
 - Nëse celulari smartphone është brenda një kase, hiqeni nga kasa.
- Në varësi të celularit tuaj smartphone, mund të mos jetë e nevojshme të shkarkoni "NFC Easy Connect" për të lidhur sistemin me celularin smartphone me një prekje. Në këtë rast, funksionimi dhe specifikimet mund të jenë të ndryshme nga përshkrimi këtu. Për hollësi të mëtejshme drejtojuni udhëzimeve të përdorimit që shoqërojnë celularin smartphone.

Shënim

Aplikacioni mund të mos jetë i disponueshëm në disa shtete dhe/ose rajone.

Dëgjimi i muzikës me lidhjen BLUETOOTH

Ju mund të dëgjoni muzikë që mbështet mbrojtjen e përbajtjes SCMS-T.

Përpara se të nisni riprodhimin e muzikës, kontrolloni si më poshtë:

- Funkcioni BLUETOOTH në pajisjen BLUETOOTH është i aktivizuar.
- Procedura e çiftimit kryhet si në këtë sistem ashtu edhe në pajisjen BLUETOOTH.

1 Shtypni për të zgjedhur "BT AU".

2 Filloni lidhjen BLUETOOTH nga pajisja BLUETOOTH.

Drita LED ndizet ose pulson në ngjyrë blu kur kryhet lidhja BLUETOOTH.

3 Filloni riprodhimin në pajisjen BLUETOOTH.

Për hollësi mbi përdorimin, shikoni "Për të komanduar një pajisje BLUETOOTH" (faqe 13).

4 Rregulloni volumnin.

Vendosni volumnin e pajisjes BLUETOOTH në një nivel të moderuar dhe shtypni \triangleleft +/-.

Këshilla

- Ju mund të rregulloni volumnin e sistemit përmes një pajisjeje BLUETOOTH që mbështet AVRCP (Audio Video Remote Control Profile) VOLUME UP/DOWN. Për hollësi, referojuni udhëzimeve të përdorimit që shoqërojnë pajisjen.
- Ju mund të mos jeni në gjendje të rregulloni volumnin, në varësi të pajisjes.

Shënime

- Nëse pajisja burimore ka funksion për përforcimin e basit ose funksion balancuesi, çaktivizojini. Nëse këto funksione janë të aktivizuara, zëri mund të jetë i shtrembëruar.
- Në rastet e mëposhtme, duhet të kryeni sërish lidhjen BLUETOOTH.
 - Nuk është ndezur sistemi.
 - Nuk është ndezur pajisja BLUETOOTH, ose funksioni BLUETOOTH është çaktivizuar.
 - Nuk është kryer lidhja BLUETOOTH.
- Nëse luhen më shumë se një pajisje të çiftuara me sistemin, do të dëgjohet tingull vetëm nga një prej këtyre pajisjeve.

Mbyllja e lidhjes BLUETOOTH


Mbyllni lidhjen BLUETOOTH duke kryer një nga veprimet e mëposhtme.

- Përdorni pajisjen BLUETOOTH për të mbyllur lidhjen. Për hollësi, referojuni udhëzimeve të përdorimit që shoqërojnë pajisjen.
- Fikni pajisjen BLUETOOTH.
- Fikni sistemin.

Funksioni rrethues

Shijimi i efektit rrethues

Ky sistem mund të krijojë tingull rrethues me shumë kanale. Mund të zgjidhni një prej fushave me tingull të optimizuar nga fushat e paraprogramuara zanore.



Zgjidhni një fushë zanore duke shtypur butonat SOUND FIELD +/- ose butonin SOUND FIELD e fushës së dëshiruar zanore.

Në ekranin e altoparlantit horizontal shfaqet fusha e zgjedhur zanore. Cilësimi i parazgjedhur i funksionit të fushës zanore të sistemit është "P.AUDIO" kur zgjidhet "ANALOG" ose "BT AU" dhe "STD" kur zgjidhet një lloj tjetër hyrjeje.

Fushat zanore të disponueshme

Fusha zanore	Efekti
STD (Standard)	U përshtatet burimeve të ndryshme.
MOVIE	Rikrijon tingull të fuqishëm dhe realist, si edhe dialogët të qartë.
DRAMA	Rikrijon dialogët e qartë të telenovelave.
NEWS	Rikrijon të folurën e qartë të edicioneve të lajmeve.
SPORTS	Rikrijon narrativ të qartë, brohoritjet me efekt emocionues rrethues, dhe prodhon tingull të fuqishëm dhe realist.
GAME	Prodhon tingull të fuqishëm dhe realist, të përshtatshëm për lojën me videolajmë.
MUSIC	Përshtatet për programet muzikore ose videot muzikore në Blu-ray Disc/DVD.
P.AUDIO (Audio portative)	Përshtatet për programet muzikore të lexuesve muzikorë portativë.
STEREO	Përshtatet për CD muzikore.

Këshillë

- Mund të caktoni një fushë të ndryshme zanore për çdo burim hyrjeje.

Cilësimet dhe përshtatjet duke përdorur menynë AMP

Përdorimi i menysë AMP

Ju mund të vendosni artikujt e mëposhtëm me AMP MENU në telekomandë. Cilësimet e parazgjedhura janë të nënvizuara.

Cilësimet ruhen edhe nëse shkëputni kordonin e rrymës së drejtpërdrejtë (rrjetit elektrik).

- 1** Shtypni AMP MENU për të aktivizuar menynë AMP.
- 2** Shtypni ← (kthimi)/↑ ↓ (zgjidh)/→ (vazhdo) në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur artikullin dhe shtypni ⊕ për të vendosur cilësimin.
- 3** Shtypni AMP MENU për të çaktivizuar menynë AMP.

Lista e menysë

Artikujt e menysë	Funksioni
LEVEL	
VOICE	Rregullon nivelin e zërit. • Parametrat variojnë nga “-6” në “+6” me rritje nga 1 hap.
SW LVL	Rregullon nivelin e nën-vuferit. • Parametrat variojnë nga “-6” në “+6” me rritje nga 1 hap.
DRC (DYNAMIC RANGE CONTROL)	E dobishme për të shijuar filma me volum të ulët të zërit. DRC aplikohet për burimet Dolby Digital. • ON: Ngjesh zërin sipas informacionit që përmban përmbajtja. • <u>AUTO</u> : Ngjesh zërin e koduar në Dolby TrueHD automatikisht. • OFF: Tingulli nuk ngjeshet.
tone	
BASS	Rregullon nivelin e basit. • Parametrat variojnë nga “-6” në “+6” me rritje nga 1 hap.
TREBLE	Rregullon nivelin e altos. • Parametrat variojnë nga “-6” në “+6” me rritje nga 1 hap.

Artikujt e menysë	Funksioni
AUDIO SYNC (AV SYNC)	Zërin mund ta vononi duke përdorur këtë sistem kur figura është më e ngadaltë se zëri. <ul style="list-style-type: none"> • ON: Rregulloni ndryshimin mes figurës dhe zërit. • OFF: Asnjë rregullim.
DUAL (DUAL MONO)	Mund të shijoni transmetim zëri multipleks kur sistemi merr sinjal transmetimi Dolby Digital multipleks. <ul style="list-style-type: none"> • M/S: Zëri kryesor del nga altoparlanti i majtë dhe zëri dytësor del nga altoparlanti i djathtë. • MAIN: Luan vetëm kanalin kryesor. • SUB: Luan vetëm kanalin dytësor.
NIGHT	Ju mund të shijoni efektet zanore dhe të dëgjoni dialogë të qartë edhe me nivel të ulët të volumit duke përdorur këtë sistem. <ul style="list-style-type: none"> • ON: Aktivizon funksionin "NIGHT". • OFF: Çaktivizon funksionin.
AAV (ADVANCED AUTO VOLUME)	I dobishëm kur ka ndryshime të papritura në volumnin e zërit, si p.sh. kur volumni në reklama është më i lartë se në program. <ul style="list-style-type: none"> • ON: Aktivizon funksionin "AAV". • OFF: Çaktivizon funksionin.
HDMI CTRL (CONTROL FOR HDMI)	<ul style="list-style-type: none"> • ON: Aktivizon funksionin Control for HDMI. • OFF: Çaktivizon funksionin. Zgjidhni këtë cilësim kur dëshironi të lidhni pajisje që nuk përputhen me "BRAVIA" Sync ose që nuk kanë fole HDMI, etj.
P. THRU* (PASS THROUGH)	<ul style="list-style-type: none"> • AUTO: Kur televizori është i ndezur ndërkohë që sistemi është në modalitet pritjeje, sistemi nxjerr sinjale HDMI nga foleja e sistemit HDMI OUT TV (ARC). Ky cilësim kursen energji në modalitetin në pritje, krahasuar me cilësimin "ON". • ON: Kur sistemi është në modalitet gatishmërie, ai gjithmonë kalon sinjale HDMI.
ARC* (AUDIO RETURN CHANNEL)	<ul style="list-style-type: none"> • ON: Zgjidhni këtë cilësim kur lidhni sistemi me një televizor të përputhshëm me teknologjinë Audio Return Channel (ARC) dhe dëgjoni tingull dixhital përmes një kabloje HDMI. • OFF: Zgjidhni këtë cilësim kur lidhni sistemi me një televizor dhe dëgjoni tingull dixhital përmes një kabloje optike dixhitale.
* Artikujt shfaqen kur "CTRL (CONTROL FOR HDMI)" vendoset vetëm në "ON".	

Artikujt e menysë	Funksioni
SET BT BT.STBY (BT STANDBY)	<p>Kur sistemi ka informacion çiftimi, ai është në modalitet gatishmërie BLUETOOTH edhe kur çaktivizohet.</p> <ul style="list-style-type: none"> • ON: Aktivizohet modaliteti i gatishmërisë BLUETOOTH. Drita LED pulson me ngadalë në ngjyrë blu kur sistemi çaktivizohet. • OFF: Çaktivizohet modaliteti i gatishmërisë BLUETOOTH. <p>Shënime</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nëse sistemi nuk ka informacion çiftimi, modaliteti i gatishmërisë BLUETOOTH nuk mund të vendoset. • Gjatë modalitetit të gatishmërisë BLUETOOTH, rritet konsumi i energjisë në modalitet pritjeje.
AAC	<p>Vendoset nëse sistemi do të përdorë apo jo AAC përmes BLUETOOTH. Ky artikull shfaqet vetëm kur sistemi nuk është lidhur me një pajisje BLUETOOTH.</p> <ul style="list-style-type: none"> • ON: Përdor AAC. • OFF: Nuk përdor AAC.
SYSTEM A. STBY (AUTO STANDBY)	<p>Mund të reduktoni konsumin e energjisë. Altoparlanti horizontal kalon automatikisht në modalitetin e gatishmërisë kur nuk përdorni altoparlantin horizontal për rreth 30 minuta dhe altoparlanti nuk merr sinjale hyrjeje.</p> <ul style="list-style-type: none"> • ON: Aktivizon funksionin "A. STBY". • OFF: Çaktivizon funksionin.
IR REP	<p>Nëse telekomanda e një televizori nuk kontrollon televizorin, altoparlanti horizontal mund të transmetojë sinjalin e telekomandës te televizori për të komanduar televizorin.</p> <ul style="list-style-type: none"> • ON: Funksioni i transmetimit është aktivizuar. • OFF: Funksioni i transmetimit është çaktivizuar.
VER	<p>Informacioni i versionit të firmuerit aktual shfaqet në ekranin e panelit të përparmë.</p>
WS LINK	<p>Përdoreni këtë artikull kur dëshironi të aktivizoni transmetimin me valë (faqe 30).</p>
RF CHK	<p>Tregon nëse është aktivizuar apo jo transmetimi me valë në sistem.</p> <ul style="list-style-type: none"> • RF OK: Është i mundur transmetimi me valë. • RF NG: Nuk është i mundur transmetimi me valë.

Lidhja e sistemit (LINK)

Ju mund të lidhni altoparlantin horizontal dhe nën-vuferin sërish për të aktivizuar mes tyre transmetimin me valë.

- 1 Shtypni AMP MENU.**
- 2 Zgjidhni "WS" me ↑ ↓ (zgjidh), më pas shtypni ⊕ ose → (vazhdo).**
- 3 Zgjidhni "LINK" më pas shtypni ⊕ ose → (vazhdo).**
- 4 Shfaqet "START", më pas shtypni ⊕.**

Shfaqet "SEARCH" dhe altoparlanti horizontal kërkon pajisje që mund të përdoren me Link. Vazhdoni te hapi tjetër brenda 1 minute. Për të mbyllur funksionin Link gjatë një kërkimi për pajisje, shtypni ←.
- 5 Shtypni LINK në pjesën e pasme të nën-vuferit me një majë stilolapsi, etj.**

Treguesi I/⏻ në nën-vuferit ndizet në të gjelbër. "OK" shfaqet në ekranin e panelit të përparmë. Nëse shfaqet "FAILED", kontrolloni që të siguroheni që nën-vuferi është ndezur dhe kryeni sërish procesi nga hapi 1.
- 6 Shtypni AMP MENU.**

Menyja AMP çaktivizohet.

Zgjidhja e problemeve

Nëse ju ndodh një nga vështirësitë e mëposhtme gjatë përdorimit të sistemit, përdorni këtë udhëzues për zgjidhjen e problemeve për t'ju ndihmuar të zgjidhni problemin përpara se të kërkontë riparime. Nëse problemi vazhdon, kontaktoni shitësin më të afërt të Sony.

POWER

Sistemi nuk është ndezur.

- Kontrolloni që kordoni i rrymës së drejtpërdrejtë (rrjetit elektrik) të jetë lidhur mirë.

Sistemi fiket automatikisht.

- Funkzioni "A. STBY" është në punë (faqe 29).

SOUND

Tingulli shumëkanalësh Dolby Digital ose DTS nuk riprodhohet.

- Kontrolloni cilësimin e audios të formatit Dolby Digital ose DTS në luajtësin Blu-ray Disc, DVD etj. të lidhur me sistemin.

Nuk arrihet efekti i tingullit rrethues.

- Në varësi të sinjalit hyrës dhe cilësimeve të fushës së zërit, përpunimi i tingullit rrethues mund të mos funksionojë me efikasitet (faqe 26). Efekti rrethues mund të jetë i lehtë në varësi të programit ose diskut.
- Nëse lidhni një luajtës Blu-ray Disc ose një luajtës DVD të përputhshëm me funksionin e efektit rrethues, efekti rrethues i sistemit mund të mos funksionojë. Në këtë rast, vendoseni funksionin e efektit rrethues të pajisjes të lidhur në të fikur. Për detaje, referojuni udhëzimeve të përdorimit të dhëna me pajisjen e lidhur.

Nga sistemi nuk del zëri i televizorit.

- Kontrolloni lidhjen e kabllot optik dixhital ose kabllot audio që lidhet me sistemin dhe televizorin (faqe 14).
- Kontrolloni daljen e zërit të televizorit.
- Nëse televizori nuk është i përputhshëm me teknologjinë Audio Return Channel (ARC), lidhni kabllon optike dixhitale përveç kabllot HDMI (faqe 14) për të nxjerrë tingullin.

Zëri del si nga sistemi ashtu edhe nga televizori.

- Fikni zërin e sistemit ose televizorit.

Figura del përpara zërit.

- Vendosni "SYNC" në "OFF" nëse "SYNC" është vendosur në "ON" (faqe 28).

Nga sistemi nuk del zëri i pajisjes së lidhur ose del një zë shumë i ulët.

- Shtypni \triangleleft + dhe kontrolloni nivelin e vullmit.
- Shtypni \otimes ose \triangleleft + për të anuluar funksionin e heshtjes.
- Kontrolloni që burimi i hyrjes të jetë zgjedhur saktë.
- Kontrolloni që të gjithë kabllot dhe kordonët e sistemit dhe pajisjes së lidhur të jenë futur plotësisht.

BLUETOOTH

Nuk ka zë.

- Sigurohuni që ky sistem të mos jetë larg nga pajisja BLUETOOTH, ose që ky sistem të mos marrë interferenca nga një rrjet Wi-Fi, pajisje tjetër me valë 2,4 GHz ose furrë me mikrovalë.
- Kontrolloni që lidhja BLUETOOTH të kryhet siç duhet mes këtij sistemi dhe pajisjes BLUETOOTH.
- Çiftoni sërish këtë sistem dhe pajisjen BLUETOOTH.

Zëri kapërcehet ose distanca e korrespondimit është e shkurtër.

- Nëse pranë ndodhet një pajisje që gjeneron rrezatim elektromagnetik, si p.sh. rrjet Wi-Fi, pajisje të tjera BLUETOOTH ose mikrovalë, lëvizeni këtë sistem larg këtyre burimeve.
- Largoni çdo pengesë mes këtij sistemi dhe pajisjes BLUETOOTH, ose largojeni sistemin nga pengesa.
- Vendoseni këtë sistem dhe pajisjen BLUETOOTH sa më pranë të jetë e mundur.
- Ripoziciononi këtë sistem.
- Ripoziciononi pajisjen BLUETOOTH.
- Ndryshoni frekuencën Wi-Fi të ruterit Wi-Fi, kompjuterit, etj. në bandën 5 GHz.

Çiftimi nuk mund të kryhet.

- Afrojeni këtë sistem dhe pajisjen BLUETOOTH më pranë.

Tingulli nuk është i sinkronizuar me imazhin.

- Kur jeni duke parë filma, mund të dëgjoni tingullin me një vonesë të vogël nga figura.

Lidhja BLUETOOTH nuk mund të kryhet.





- Sigurohuni që pajisja BLUETOOTH që do të lidhet të jetë ndezur dhe të jetë aktivizuar funksioni BLUETOOTH.
- Lidhja BLUETOOTH është shkëputur. Kryeni sërish lidhjen BLUETOOTH.

Pajisjet BLUETOOTH nuk mund të komandohen me telekomandën e sistemit.

- Komandojeni pajisjen BLUETOOTH më vete.

WIRELESS SOUND

Transmetimi me valë nuk është aktivizuar ose nuk ka zë nga nën-vuferi.

- Kontrolloni statusin e treguesit  në nën-vufer.
 - Është fikur:
 - Kontrolloni që kordoni i rrymës së drejtpërdrejtë (rrjetit elektrik) i nën-vuferit të jetë lidhur mirë.
 - Ndizni nën-vuferin duke shtypur  në nën-vufer.
 - Pulson në ngjyrë të kuqe.
 - Shtypni  për të fikur nën-vuferin dhe kontrolloni që asgjë të mos bllokojë vrimat e ventilimit të nën-vuferit.
 - Pulson me ngadalë në ngjyrë të gjelbër ose është ndezur në ngjyrë të kuqe:
 - Lëvizni nën-vuferin në mënyrë që treguesi  të ndizet në të gjelbër.
 - Kontrolloni statusin e transmetimit me valë (faqe 29).
 - Vendosni transmetimin me valë (faqe 30).
 - Pulson me shpejtësi në ngjyrë të gjelbër.
 - Kontaktoni shitësin më të afërt të Sony.

Tingullin kapërcehet ose ka zhurmë.

- Nëse pranë ndodhet një pajisje që gjeneron rrezatim elektromagnetik, si p.sh. rrjet Wi-Fi ose mikrovalë, lëvizeni këtë sistem larg këtyre burimeve.
- Largoni çdo pengesë mes altoparlantit horizontal dhe nën-vuferit, ose largojeni sistemin nga pengesa.
- Vendoseni altoparlantin horizontal dhe nën-vuferin sa më pranë të jetë e mundur.
- Ndryshoni frekuencën Wi-Fi të ruterit Wi-Fi, kompjuterit, etj. në bandën 5 GHz.

OTHERS

Telekomanda nuk funksionon.

- Drejtojeni telekomandën drejt sensorit të telekomandës **R** në sistem.
- Largoni çdo pengesë mes telekomandës dhe sistemit.
- Zëvendësoni të dyja bateritë në telekomandë me të reja, nëse ato janë të shkarkuara.
- Sigurohuni që të zgjidhni hyrjen e saktë në telekomandë.

Funksioni Control for HDMI nuk funksionon mirë.

- Kontrolloni lidhjen HDMI (faqe 14).
- Konfiguroni funksionin Control for HDMI në televizor.
- Sigurohuni që pajisja e lidhur të jetë e përputhshme me "BRAVIA" Sync.
- Kontrolloni cilësimet e Control for HDMI në pajisjen e lidhur. Referojuni udhëzimeve të përdorimit të dhëna me pajisjet e lidhura.
- Nëse lidhni/shkëputni kordonin e rrymës së drejtpërdrejtë (rrjetit elektrik), prisni më shumë se 15 sekonda dhe vëreni në punë sistemin.
- Nëse lidhni daljen audio të pajisjes video dhe sistemin duke përdorur kablo tjetër nga HDMI, mund të mos dalë zë për shkak të "BRAVIA" Sync. Në këtë rast, vendoseni "CTRL" në "OFF" (faqe 28) ose lidhni folenë e daljes audio direkt me televizorin në vend të sistemit.

"PROTECT" shfaqet në ekranin e panelit të përparmë.

- Shtypni I/⏻ për të fikur sistemin. Pasi të zhduket "STBY", shkëputni kordonin e rrymës AC (rrjetit elektrik), kontrolloni që asgjë të mos bllokojë vrimat e ventilimit të sistemit.

RESET

Nëse sistemi vazhdon të mos punojë mirë, rivendoseni sistemin si më poshtë:

- 1 Shtypni I/⏻ për të ndezur altoparlantin horizontal.**
- 2 Shtypni I/⏻ ndërkohë që shtypni INPUT dhe VOL – në altoparlantin horizontal.**
- 3 Kur "RESET" shfaqet në ekranin e panelit të përparmë, lëshoni butonat.**
- 4 Shkëputni kordonin e rrymës së drejtpërdrejtë (rrjetit elektrik).**

Menyja AMP, fusha zanore, etj. kthehen në cilësimet e parazgjedhura.

Specifikimet

Formatet e mbështetura nga ky sistem

Dolby Digital	DTS-HD Master Audio*
Dolby Digital Plus*	DTS-HD High Resolution Audio*
Dolby TrueHD*	DTS-HD Low Bit Rate*
DTS	PCM linear me 2 kanale 48 kHz ose më pak
DTS 96/24	PCM linear maksimumi me 7.1 kanale 192 kHz ose më pak*

* Këto formate mund të vendosen vetëm me lidhje HDMI.

HDMI

Hyrja/dalja (HDMI Blloku i repetitorit)

Skedari	2D	3D		
		Frame packing	Side-by-Side (Half)	Over-Under (Top-and-Bottom)
4096 × 2160p @ 23,98/24 Hz	○	-	-	-
3840 × 2160p @ 29,97/30 Hz	○	-	-	-
3840 × 2160p @ 25 Hz	○	-	-	-
3840 × 2160p @ 23,98/24 Hz	○	-	-	-
1920 × 1080p @ 59,94/60 Hz	○	-	○	○
1920 × 1080p @ 50 Hz	○	-	○	○
1920 × 1080p @ 29,97/30 Hz	○	○	○	○
1920 × 1080p @ 25 Hz	○	○	○	○
1920 × 1080p @ 23,98/24 Hz	○	○	○	○
1920 × 1080i @ 59,94/60 Hz	○	○	○	○
1920 × 1080i @ 50 Hz	○	○	○	○
1280 × 720p @ 59,94/60 Hz	○	○	○	○
1280 × 720p @ 50 Hz	○	○	○	○
1280 × 720p @ 29,97/30 Hz	○	○	○	○
1280 × 720p @ 23,98/24 Hz	○	○	○	○
720 × 480p @ 59,94/60 Hz	○	-	-	-
720 × 576p @ 50 Hz	○	-	-	-
640 × 480p @ 59,94/60 Hz	○	-	-	-

Altoparlanti horizontal (SA-CT660)

Seksioni i amplifikatorit

DALJA E FUQISË (nominale)

I përpamë majtas + I përpamë
djathtas: 50 W + 50 W
(në 3 om, 1 kHz, 1 % THD)

DALJA E FUQISË (referencë)

I përpamë majtas/I përpamë
djathtas: 100 W (për kanal në 3 om,
1 kHz)

Hyrjet

HDMI IN 1/2/3

ANALOG IN

OPTICAL IN

Dalja

HDMI TV OUT (ARC)

Seksioni BLUETOOTH

Sistemi i komunikimit Specifikimi

BLUETOOTH versioni 3.0

Dalja Specifikimi

BLUETOOTH kategoria e fuqisë 2

Rrezja e komunikimit maksimal

Fushë shikimi rreth 10 m¹⁾

Brezi i frekuencës

Brezi 2,4 GHz (2,4000 GHz -
2,4835 GHz)

Metoda e modulimit

FHSS (Freq Hopping Spread
Spectrum)

Profillet e përputhshme BLUETOOTH ²⁾

A2DP (Advanced Audio Distribution
Profile)

AVRCP 1.3 (Audio Video Remote
Control Profile)

Kodekët e mbështetur³⁾

SBC⁴⁾, AAC⁵⁾

Gama e transmetimit (A2DP)

20 Hz - 20 000 Hz (Frekuenca
e modulimit 44,1 kHz)

- 1) Rrezja aktuale varet nga faktorë si pengesat mes pajisjeve, fushat magnetike rreth një furre me mikrovalë, elektriciteti statik, telefonat me valë, ndjeshmëria e marrjes, sistemi operativ, përdorimi i softuerëve, etj.

- 2) Profillet standarde BLUETOOTH tregojnë qëllimin e komunikimit BLUETOOTH mes pajisjeve.
- 3) Kodeku: Ngjeshja e sinjalit audio dhe formati i konvertimit
- 4) Kodeku i nën-brezi
- 5) Kodim i përparuar audio

Njësia e altoparlantit të përpamë

Sistemi i altoparlantëve

Sistem altoparlantësh me 2 drejtime,
pezullim akustik

Njësia e altoparlantit

Nën-vuferi: 50 mm × 90 mm lloji
konik

Altoparlanti për frekuenca të larta:
20 mm i llojit me balancim

Rezistenca nominale

3 om

Të përgjithshme

Furnizimi me energji

220 V - 240 V AC, 50/60 Hz

Konsumi i energjisë

Ndezur: 34 W

"Control for HDMI" është fikur
(modaliteti i gatishmërisë): 0,3 W
ose më pak

BLUETOOTH Modaliteti
i gatishmërisë: 0,5 W ose më pak

Përmasat (afërsisht)

1030 mm × 109 mm × 94 mm
(me mbajtëset)

1030 mm × 95 mm × 107 mm
(pa mbajtëset)

Masa (afërsisht)

3,5 kg

Nën-vuferi (SA-WCT660)

DALJA E FUQISË (referencë)

130 W (për kanal në 4 om, 100 Hz)

Sistemi i altoparlantëve

Nën-vuferi, Refleksi i basit

Njësia e altoparlantit

160 mm lloji konik

Rezistenca nominale

4 om

Furnizimi me energji

220 V - 240 V AC, 50/60 Hz

Konsumi i energjisë

Ndezur: 30 W

Modaliteti i gatishmërisë:

0,5 W ose më pak

Përmasat (afërsisht)

271 mm × 404 mm × 271 mm

(gj/l/th)

Masa (afërsisht)

8,6 kg

Transmetuesi/marrësi me valë

Sistemi i komunikimit

Specifikimi i tingullit me valë

versioni 2.0

Brezi i frekuencës

Brezi 2,4 GHz (2,4000 GHz -

2,4835 GHz)

Metoda e modulimit

Pi/4 DQPSK

Dizajni dhe specifikimet i nënshtrohen ndryshimit pa dhënë njoftim.

- Konsumi i energjisë në gatishmëri: 0,3 W ose më pak (altoparlanti horizontal), 0,5 W ose më pak (nën-vuferi)
- Arrihet efikasitet mbi 85% i bllokut të amplifikatorit me amplifikues të plotë dixhital, S-Master.

Indeksi

Simbolet

↻ 10

⊗ 12

↙ 10, 12

A

A. STBY 29

AAC 29

AAV 28

ARC 28

B

BASS 27

BLUETOOTH 5, 22

BT.STBY 29

C

CTRL 28

D

DRC 27

DUAL 28

F

Fusha zanore 26

I

Instalimi 16

IR REP 29

L

Lidhja

Kabloja optike dixhitale 14

Luajtës DVD 14

TV 14

LINK 30

M

Menyja AMP 27

N

NIGHT 28

P

P. THRU 28

Paneli i ekranit të përparmë 11

Pozicionimi i sistemit 16

PROTECT 33

R

RF CHK 29

Rivendosja 33

S

Sistemi me valë 18

SW LVL 27

SYNC 28

T

Telekomanda

përdorimi 12

përgatitja 9

TREBLE 27

V

VER 29

VOICE 27

HDMI

<http://www.sony.net/>

4-452-002-21(5) (AL)



* 4 4 5 2 0 0 2 2 1 * (5)